



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

të mbledhjes së dytë të Komitetit Konsultativ për personat me aftësi të kufizuara,
mbajtur më 07.05.2021, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, anëtarët e Komitetit:
Ramadan Salihu, Jeton Canhasi, dhe Armend Ademi.
Munguan: Mehreme Llumnica, Ermira Shabani dhe Gyltene Retkoceri.

E pranishme ishte edhe Prentima Preniqi, koordinatore e njësisë për të drejtat e njeriut
dhe Besa Preniqi - interprete.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese .
Kryesuesja konstatoi se u miratua ky

REND DITE:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit konsultativ
të personave me aftësi të kufizuara;
2. Diskutim -Plani i Veprimit për PAK-ra në kuadër të Komunës së Prishtinës.
3. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit konsultativ të
personave me aftësi të kufizuara.

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së
parë të Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara.

Armend Ademi tha në takimin e fundit në të ndryshme qenka diskutuar lidhur me parkingun që është tu ndërtuar ku janë paraparë 700 vend parkingje prej të cilave 24 janë paraparë për PAK-ra, ndoshta kishte qenë mirë me cekur edhe me hyrë që mu liruar në bazë të librezës së anëtarësimit PAK-ra dhe me qenë kjo dokumentuar që pastaj secili prej nesh mi lajmëruar anëtarët e shoqatave të tyre.

Jeton Canhasi dha sqarime duke cekur se kjo është e qartë krejt ky parking është privat - publik shpresoj që do të lirohen, paraprakisht duhet me pasur librezën e anëtarësimit, mundem me fol me personat kompetente se a munden mu liruar nga pagesa PAK-ra dhe në takimin tjetër ju informoj.

Premtime Preniqi dha sqarime se ka pyet lidhur me këtë çështje në Shërbimet Publike zyrtarin Habib Qorrin dhe ju ka përgjigjur se është kompetencë e "Prishtina Parkingut" mirëpo si rekomandim apo diç të tillë gjithë është që gjithsesi me qenë pjesa e parkingut për PAK-ra.

Armend Ademi tha kishte qenë mirë me kontaktuar me të parkingut dhe me diskutuar këtë çështje, kush ka mundësi me marrë përgjegjësin që me marrë informata.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese tha se zotëri Jetoni pe merr përgjegjësin me kontaktuar me përgjegjësit .

Jeton Canhasi tha ndoshta Armendi nuk është në dijeni që Kompania jonë e udhëheq mbikëqyrjen dhe jemi aty gjatë gjithë ndërtimit.

Pika e dytë

Diskutim -Plani i Veprimit për PAK-ra në kuadër të Komunës së Prishtinës.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese tha Plani i Veprimit për PAK-ra në Komunën e Prishtinës është funksional që nga viti 2018-2020, muajin e kaluar në prill të këtij viti kryetari i Komunës e ka lëshuar një Vendim dhe i ka caktuar disa persona për me punuar Planin e Veprimit 2021 e tutje ku kryesues në atë Vendim është Premtime Preniqi dhe një ndër anëtarët e Plani të Veprimit jam edhe unë.

Premtime Preniqi dha sqarime duke cekur se e kanë planifikuar, ky është vetëm grupi i parë, për ndryshe Plani ka mu bërë një takim i veçantë ku kemi me marrë pjesë anëtarët e grupit dhe kemi me shqyrtuar këtë planë mirëpo kjo është vetëm pjesë formale që kemi me përgatitur për përbajtje, hyrje etj. e sa për pjesën e aktiviteteve me kontrolluar çka është realizuar në atë Planin e kaluar dhe çka tash faktikisht kemi me mbajtur një takim edhe me ju anëtarët e Komitetit konsultativ për PAK -ra.

Ramadan Salihu u shpreh se lajmin më të mirë që e ka dëgjuar deri më tanë në këtë Komitet është ky Plan, edhe pse nuk pres diçka prej këtij Plani por kjo reflekton një interesim institucioni, nga ka lindur iniciativa nuk e di.

Premtime Preniqi dha sqarime se iniciativa ka qenë prej kabinetit të kryetarit, ka qenë se është faktikisht një dokument i cili pastaj kërkohet nëpër dokumente tjera ku patjetër na duhet me pas si Komunë një Plan.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese tha kemi filluar veç takimin e parë për Planin e Veprimit, gjithsesi një draft do ta ndajmë bashkë me Komitetin do ta keni në email dhe një kopje fizike dhe do te keni mundesi secili anëtarë i komitetit me dhënë kontributin me aktivitetet që janë të parapara dhe çka doni ju me ndryshuar secili në aktivitetet të cilat janë paraparë.

Premtime Preniqi si grup për hartimin e këtij Plani e kemi shumë më lehtë në krahasim me Planin e kaluar se në planin e kaluar kanë marrë pjesë krejt institucionet e mundshme dhe organizatat ka shumë gjëra të cilat janë shqyrtuar vërtetë me një përbajtje shumë të mirë e tash neve na mbetet vetëm të njëjtën aktivitet mi shikuar dha anën tjetër me shikuar sa është realizuar dhe sa nuk është realizuar.

Jeton Canhasi tha si propozim kishte qenë mirë me ju dhënë një shenjë me emër me ngjitur në vetura PAK -ra mu identifikuar që është PAK-ra në mënyrë kur të shkon në parking me pas të drejt me shfrytëzuar.

Premtime Preniqi tha ka qenë si ide në disa takime kur kemi biseduar me nivelin Komunal kjo ide, mirëpo puna e mungesës së këtyre parkingjeve s'ka funksionuar kjo punë mirëpo kurë të bëhen parkingjet posaçërisht atëherë mu vendos kjo dhe vendosen shenjat për parking, vendoset aty shenja në rrugë dhe besoj se ai që nuk e ka shenjën e parkohet aty dënohet.

Armend Ademi tha pak ndoshta këto nuk po janë të mbikëqyrura këto vendet që e kanë shenjën për PAK-ra kështu që një herë a dy mi dënuar nuk do ti kishin shfrytëzuar këto parkingje personat qe nuk janë të dedikuar mi shfrytëzuar këto parkingje.

Premtime Preniqi tha me siguri tanë kur të filloj me funksionuar së pari "Prishtina Parking" mirë edhe këto parkingjet e tjera të mirëfillta besoj ka mu rregulluar kjo çështje.

Të ndryshme

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese tha kolegia Gyltene mungon në këtë takim nga takimi i fundit ka pasur përgjegjësi me i dërguar email drejtorisë së Shëndetësisë për mi dhënë prioritet vaksinimit të PAK -ra, kjo drejtori ja ka kthyer automatikisht emailin me përgjigje se nuk është përgjegjësi e jona por vaksinimin është me IKSHPK dhe kolegia ju dërguar email edhe IKSHPK dhe nuk ka marrë përgjigje andaj ju lus për çdo email që ka dërguar email edhe IKSHPK dhe nuk ka marrë përgjigje andaj ju lus për çdo email që dërgoni për një kërkesë të tillë ajo mu përsëritur disa here ose me kontaktuar me telefon se për ndryshe se e kanë vështirësi mi kthyer emailet për shkak të punëve dhe angazhimeve që i ka IKSHPK.

Poashtu pyet zotëri Ramadanin për projektin që e ka dërguar në drejtorin e Sportit lidhur me subvencionim.

Ramadan Salihu dha sqarime se e ka dërguar kërkesën dhe beson se angazhimi i Premtimes ka ndikuar që të janë ma konkret dhe të afërt me neve mirëpo a do të miratohet kjo kërkesë e jonë apo jo nuk e di, a projekti është ai të cilin e kemi miratuar këtu.

Po ashtu ceku se kërkesën që e kanë bërë për takim me drejtorin Dren Kukaj nuk ju ka përgjigjur.

Premtime Preniqi tha drejtori Dren ka kontribuar shumë për OJQ-re por në këtë rast pse nuk e di.

Ramadan Salihu tha drejtori Dreni në disa OJQ-re ka investuar si.p.sh "Hendikos" ja kanë rinouar në tërësi objektin, ja kanë mobiluar, ja kanë paguare qiranë etj ndërsa për Shoqatën e të Verbërve nuk kanë bërë asgjë kështu që ka investuar ku nuk është dashtë e ku ka pasur nevojë jo.

Armend Ademi u interesua se a është fjala për Shoqatën e të verbërve që gjendet me lokacion te shkolla "Elena Gjika".

Ramadan Salihu dha sqarime duke cekur se jonë dy objekte njëri është tu rrënuar, tualetet janë mizore për të shëndoshe e jo për të verbër, zyret janë në gjendje të keqe kështu që asnjë cent, as një investim aty nuk është bërë.

Armend Ademi tha sa i përket drejtorit Dreni sa e shoh unë ky ka bërë shumë për OJQ-të, dhe ato OJQ që i kanë marrë mi rinouar janë në rregull deri tani sa i kam pa unë, për çdo projekte që nuk miratohet që i ndal banka nga 10 euro ndoshta kish qenë mirë mi ndal krejt këto 10 eurot për të gjitha OJQ-te, ke kush ke banka.

Unë propozoj që na si Forum me bërë një kërkesë te Bujari me kontaktuar ai me BQK me personin përgjegjës që mi liruar prej kësaj pagese bankat këto OJQ -të që i ndalen tatim, nuk e di sa është e mundur mu bo kjo punë nëse kishim kontaktuar me BKQ për lirim.

Ramadan Salihu tha jo, por OJQ -të duhet të jenë azhure, nuk ka rendësi ajo me bërë ata por me qenë azhur OJQ-të me likuiduar krejt projektin qysh është i paraparë.

Armend Ademi tha a mundemi me bërë një kërkesë me dërguar në BQK.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese tha nuk mundemi me bërë një kërkesë të tillë se BQK -së është në Nivel Qendor.

Armend Ademi tha ne e dërgojmë një kërkesë në Forumin e aftësive të kufizuara që është për krejt Kosovën si ide e ata me biseduar me BQK-së.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese tha Armend caktoje ti një takim me Bujarin nëse na pranon shkojmë si Komitetet e diskutojmë për këtë çështje, e sugjeroi Amendin të shkruaj një email e t'ia dërgoi si kryesueses qe me dërguar në emër të Komitet.

Armend Ademi tha anëtarët e shoqatës kur kanë shkuar në vizitë mjekësore në QKUK deri tani e kanë paraqitur librezën e anëtarësisë dhe kanë qenë të liruar prej pagesës së vizitave, tani dy muajt e fundit janë duke ju kërkuar edhe një Vendim por jo krejt janë shfrytëzues të skenës penzionale tani ai që nuk ka Vendim nuk po ju pranojnë librezën e anëtarësimit të shoqatës.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese tha QKUK-ja është Nivel Qendor, ne mundemi me bërë diç vetëm në QMF-re.

Armend Ademi tha në QMF-re nuk po kanë problem vetëm QKUK, po ashtu parashtroi pyetje se me Ligj a janë që të lirohen po PAK -ra.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese tha nuk e kam këtë informatë.

Ramadan Salihu tha me Ligj e kanë këtë të drejt QMF-re, veç ata që nuk po i shikojnë këto gjëra , mirëpo në QKUK asnjë nuk duhet me ju pranuar librezat me Ligj mirë që nuk pi shikojnë këto gjëra se pa Vendim se anëtarë i shoqatës librezën mundet me pas gjithkush kjo nuk do të thotë krejt Kosova mu liruar prej çdo gjëje krejt popullsinë por vetëm ata që janë invalid e invalid në Hendikos ka shumë që nuk e kanë Vendimin janë anëtarë të Hendikosit me marrë ndonjë shërbim etj, prandaj libreza kanë gjithë ata andaj ata kanë të drejt të QKUK -së kërkojnë atë Vendim si konfirmim që ti me të vërtetë je invalid dhe ata në këtë rast nuk e shkelin Ligjin asgjë.

Armend Ademi tha këto të arritura që paskan qenë për Planin e Veprimit 2018-2020 ndoshta kishte qenë mirë disa të arritura më kryesore mi zgjedh dhe mi postua në Fb të forumit që mi pa edhe qytetarët dha anëtarët e secilës shoqatë mi pasur këto informata.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese tha nëse mundesh Armend i ke ekstraktet, i ke këto të arriturat nëse mundesh mi publikuar në FB që e kemi si Komitet, lirisht publikoj.

Armend Ademi tha pajtohem mi publikuar dhe mi zgjedhur ato por më duhet dhe me video mi bërë në gjuhën e shenjave që mi pa ato informata edhe personat e shurdhët, nëse jeni të pajtimit.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese tha se është e pajtimit e përkrah .

Armend Ademi tha nëse jeni të pajtimit, nëse më lejohet mi zgjedh unë e pastaj mi shikuar a jeni të pajtimit edhe ju për cilat po ja merr mendja edhe juve.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese tha çka do që publikon prej komitetit edhe ashtu ka me qenë publike në veb-faqe cilëndo që e publikon aty te komiteti që e kemi në FB nuk prish punë.

Mbledhja përfundoi në orën 10:50.

Procesmbajtësja:
Shyhrte Islami

Kryesuesja e Komitetit
Fatime Demolli - Mustafa

